

Gonorea dhe klamidia janë **sëmundje që transmetohen seksualisht** (STDs), të cilat merren në rast se kryeni **seks të pambrojtur** me një person tjetër (penis në vaginë, gojë me penis, gojë me vaginë, seks anal). Këto dy sëmundje janë mjaft të përhapura midis adoleshentëve në Filadelfia.

Shumica e rasteve të gonorreas dhe klamidias **nuk kanë shënja, ose simptoma** kështu që mënyra e vetme që të dini nëse jeni i infektuar, është të kryeni testin.

Testi është **konfidencial**. Ne zbatojmë ligjet e HIPPA, kështu që informacioni i marrë nga testet nuk i jepet asnjërit, përfshirë familjen tuaj, mësuesit, ose të dashurit/dashurës.

Testi **nuk është i detyrueshëm**. Ju nuk duhet të urinoni në epruvetë, por duhet të plotësoni një fletë të bardhë dhe të shkoni në banjo.


PROCEDURAT E TESTIMIT

1. Çdo nxënës merr një qese ngjyrë kafe.
2. Çdo nxënës plotëson kartonin e bardhë.
3. Çdo nxënës e vendos këtë karton në qese.
4. Çdo nxënës duhet të futet në banjo.

5. **Nëse doni të kryeni testin:**

Urinoni në epruvetën e dhënë, mbylleni atë plotësisht dhe vendoseni në qesen e errët bashkë me kartonin e bardhë.

6. Ne do ti mbledhim të gjitha qeset e errëta, kur ju të dilni nga banjoja
7. Rezultatet e testit do të jenë gati për 2 javë.



NË RAST SE KENI KRYER MARRDHËNIE SEKSUALE JU DUHET TË KRYENI TESTIN MENJËHERE